



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.356/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur përkitazi me apelin e Lulzim Mziu nga Zvicra, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të mos përfshirjes në listën e votuesve, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.10.2019, mori këtë:

## V E N D I M

**Hudhet i pasafatshëm apeli**, i identifikuar me numër: Anr.356/2019, i datës 26.09.2019, i paraqitur nga Lulzim Mziu nga Zvicra, kundër Vendimit të KQZ-së, për Certifikimin e Listës së Votuesve.

## A r s y e t i m

Me datë 08.10.2019 PZAP-i, ka pranuar një apel nga Lulzim Mziu, të dërguar përmes postës më datë 26.09.2019, me të cilën pretendon se i është mohuar e drejta për të votuar për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 06.10.2019. Sipas paraqitësit të ankesës, i njëjti, bashkë me familjen e tij, ka aplikuar për regjistrim përmes email-it, më datë 09.09.2019, me ç'rast ka dërguar gjithë dokumentacionin e nevojshëm, ndërsa më datë 19.09.2019, ka pranuar një email, me njoftimin se nuk i është pranuar regjistrimi. Në fund ka kërkuar të dijë arsyen e mos përfshirjes së tij dhe familjes në regjistër të votuesve.

Paneli pas vlerësimit paraprak të afatshmërisë së apelit, gjeti se:

### **Apeli është i pasafatshëm**

Paneli konstaton se Vendimi i KQZ-së, për Certifikimin e Listës së Votuesve, është publikuar me datën 19.09.2019, ndërsa afati për apel ka qenë njëzetekatër (24) orë nga momenti i publikimit të vendimit të KQZ-së.

Nga apeli i paraqitur nga Lulzim Mziu i pranuar në PZAP me datë: 08.10.2019, i cili ka arritur përmes postës konstatohet se apeli është paraqitur datën e dorëzimit me postë e që

është data: 26.09.2019, vërtetohet se apeli është i paraqitur pas kalimit të afatit ligjor, andaj si i tillë është hüdë poshtë i pas afatshëm.

Me nenin 122 paragraf 1 të LZP-së, përcaktohet se: “Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë prekur nga cilat do vendime të KQZ-së, mund të apelojë atë vendim në PZAP, brenda (24) orëve”. Në këtë kuptim nga shqyrtimi i shkresave të lëndës rezulton se periudha e aplikimit për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, ka filluar nga data 30.08.2019 dhe ka përfunduar me datë 10.09.2019. Vendimi i KQZ-së, për Certifikimin e Listës së Votuesve, është publikuar me datën 19.09.2019, ndërsa afati për apel ka qenë njëzetekatër (24) orë nga momenti i publikimit të vendimit të KQZ-së. Apeli është paraqitur nga apeluesi përmes postës, më datë 26.09.2019, që do të thotë se apeluesi apelin e ka parashtruar pas afatit të përcaktuar me nenin 122 par.1 të LZP-së.

Nga arsyet e theksuara më lart e në kuptim të nenit 115 paragraf 1, dhe 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**  
Anr. 356/2019 me datë 10.10.2019

**Kryesues i Panelit**  
Faton Ademi



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi lejohet e drejta në ankesë, në Gjykatën Supreme të Kosovës e cila mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.